

Adresa të dobishme :

- ❑ **Police secours** (Policia) Tel: 117
- ❑ **Urgences médicales** (Urgjencat mjekësore) Tel: 144
- ❑ **La Main Tendue** (Dora e zgjatur për ndihmë) Tel: 143
- ❑ **Hébergement d'urgence** (Strehim urgjence) Tél: 0800 880 480
- ❑ **Solidarité femmes** (Solidariteti i grave / Qëndër konsultimi dhe mikpritje për gratë e keqtrajtuara)
Tel: 032 886 46 36 (www.sfne.ch)
- ❑ **Centre de consultation LAVI** (Qendra e konsultimit LAVI / për viktimat e agresuara) Neuchâtel, Tel: 032 889 66 49
(LAVI.Neuchatel@ne.ch)
La Chaux-de-Fonds, Tel: 032 889 66 52 (LAVI.VCH@ne.ch)
- ❑ **Service pour les auteur-e-s de violence conjugale** (Shërbimi për autorë-e-t e dhunës bashkëshortore) Tél: 032 886 80 08
(savc@cnp.ch)
- ❑ **Consultation couples et familles à transactions violentes** (Konsultim për çifte dhe familje me raporte të dhunshëm)
Neuchâtel, Tél: 032 722 12 21
La Chaux-de-Fonds, Tél: 032 967 20 61
- ❑ **Service de la cohésion multiculturelle** (Zyra e të deleguarit për të huaj / Këshilla dhe orientim në gjuhë të huaja)
Neuchâtel, Tel: 032 889 48 50
La Chaux-de-Fonds, Tel: 032 889 74 42 (www.ne.ch/cosm)
- ❑ **Office de la politique familiale et de l'égalité** (Zyra e politikës familiare dhe barazisë)
Tel: 032 889 61 20 (www.ne.ch/egalite)

Informacione më të hollësishme mbi dhunën bashkëshortore janë në dispozicionin tuaj në broshurën "**Dhuna bashkëshortore: çfarë të bëj?**", që mund të komandohet në Zyrën e politikës familiare dhe të barazisë (Escalier du Château 6, 2001 Neuchâtel, 032 889 61 20, opfe@ne.ch).

Kjo fletëpalosje mund të komandohet në **Zyrën e politikës familiare dhe të barazisë**, ose të shkarkohet në sitin internet.

Gjendet gjithashtu në **gjuhët kryesore të komuniteteve të huaja** që janë vendosur në kantonin tonë dhe mund të riprodhohet pa patur nevojë për autorizim.

Mund të konsultoni sitin www.violencequefaire.ch

Dhunë Bashëshortorë

Dhuna bashkëshortore është e palejueshme dhe e dënueshme !

Kërkoni ndihmë pa hezitim !

Broshurë e realizuar nga :

Zyra e politikës familiare dhe e barazisë
Zyra e të deleguarit për të huajt

Version albanaise



Jeni viktmë i/e dhunës bashkëshortore ?

Dhuna bashkëshortore mund të marrë forma të ndryshme:

Ju vuani nga **dhuna psikologjike**, p.sh. nëqoftëse partneri juaj:

- Ju fyen
- Ju poshtëron
- Ju kërcënon
- Shkatëron gjërat e juaja personale
- Kontrollon orarin dhe komunikimet e juaja
- Ju ndalon të dilni vetëm
- Ju ndalon të takoheni me miqtë apo të afërmit e juaj
- Ju izolon
- Ju ngacmon në mënyrë të vazhdueshme

Ju vuani nga **dhuna ekonomike**, p.sh. nëqoftëse partneri juaj :

- Nuk kontribon në bazë të së ardhurave të tija për shpenzimet e bashkëjetesës
- Përvehtëson paratë tuaja kundër dëshirës tuaj
- Kontrollon sistematikisht shpenzimet e juaja

Ju vuani nga **dhuna fizike**, p.sh. nëqoftëse partneri juaj :

- Ju shtyn brutalisht
- Ju godet me shpullë
- Ju godet me grushta ose me shqelma
- Ju kafshon
- Ju djeg
- Ju plagos me një thikë ose me një armë, ose çdo lloj gjëje tjetër

Ju vuani nga **dhuna seksuale**, p.sh. nëqoftëse partneri juaj :

- Ju dhunon
- Ju detyron të kryeni kontakte seksuale pa dëshirën tuaj

Këto akte janë të palejueshme dhe në shumicën e rasteve, të dënueshme, ciladoqofshin arsyet

Të flisni mbi nënshttrimin tuaj ndaj dhunës është një hap i parë për të zhvilluar situatën

Liqi ju mbron : lajmëroni policinë !

Policia ka të drejtë të **shoqërojë në zyrat e policisë** një person që provohet se ka kryer dhunë në drejtim të bashkëshortit të tij. Ajo ka të drejtë, gjithashtu, të **nxjerrë jashtë** një person të dhunshëm nga banesa e tij si edhe nga ambientet rrethëqark saj dhe t'i **ndalojë hyrjen** në disa vende e lokale. Viktima mund t'i kërkoj gjykatës një masë më të gjatë.

**Disa situata dhune bashkëshortore dënohen automatikisht (pa padi penale)
Një padi ju mundëson të jepni mendimin tuaj ne procedurën penale dhe të shikoni dosjen**

Mund të merrni ndihmë

Edhe nëse nuk doni të thërrisni policinë, shërbimet janë këtu për t'ju dëgjuar, ju këshilluar, dhe nëse keni nevojë,

- për t'ju organizuar një strehim
- për t'egzaminuar ndihmat ekonomiket e mundshme
- për t'ju informuar mbi të drejtat e juaja

Adresojuni qëndres LAVI ose Solidariteti i grave. Konsultimet janë falas dhe konfidencialë. Mund të zhvillohen në prani të një përkthyesi/përkthyesë

Doni të braktisni banesën bashkëshortore ?

Ju keni të drejtë **të braktisni banesën bashkëshortore**. Nëqoftëse jeni viktimë i/e dhunës bashkëshortore ose ndiheni i/e kërcënuar, liqji ju autorizon të kërkonit një mbrojtje. Mund të shkoni tek njerëz të besuar. Strehime urgjence të përkohshme mundet gjithashtu t'ju mirëpresin, vetëm ose me fëmijët tuaj. Në bazë të mundësisë, kërkonit nga një mjek të bëjë një **konstatim mjekësor** të hollësishëm, duke përshkruar të gjitha gjurmët dhe lezionet e mbetura nga agresioni, së bashku me pasojat psikike (shoku, ankthi, pagjumësia). Kjo do t'ju mundësojë të konservoni një provë, e cila mund të jetë e dobishme më vonë.

Viktimit e huaja të dhunës bashkëshortore nuk e humbasin automatikisht lejen e tyre të qëndrimit në rast ndarje apo divorci. Ato kanë një analizë specifike që merr parasysh situatën personale dhe rrethanat e tyre në çdo rast.